



Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

MANDATI

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX Kosovo) filloi punën në vitin 2008, si misioni civil më i madh i Politikës të Përbashkët të Bashkimit Evropian për Siguri dhe Mbrojtje.

EULEX-i mbështet institucione të caktuara të sundimit të ligjit të Kosovës në rrugën e tyre drejt rritjes së efektivitetit, qëndrueshmërisë, shumë-etnicitetit dhe llogaridhënies, të lira nga ndërhyrjet politike dhe në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktikën evropiane më të mira, përmes aktiviteteve të monitorimit, mentorimit dhe këshillimit, si dhe ka funksione ekzekutive të kufizuara.



KOHËZGJATJA E MANDATIT AKTUAL

15 qershor 2025 – 14 qershor 2027



BAZA LIGJORE

Vendimi i Këshillit (CFSP) 2025/1161

Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP, shkurt 2008
Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999)



Shef i Misionit

Antero Lopes (Portugali)



LOKACIONI

Selia e Misionit dhe Kompleksi i EULEX-it në Prishtinë
Qendra e EULEX-it në Mitrovicë: Mitrovica e jugut



KOMPONENTËT E DEPARTAMENTIT TË OPERACIONEVE TË EULEX-IT

EULEX-i bën vlerësimin e respektimit të obligimeve për sundim të ligjit dhe të drejta të njeriut nga ana e institucioneve të caktuara të Kosovës – me zotim të qartë kundër çdo forme të shkeljes së të drejtave të njeriut apo të diskriminimit – përmes komponentëve të tij operacionalë:

Informatat
dhe
Operacionet
Policore

Drejtësia
dhe
Shërbimi
Korrektues

DREJTËSIA DHE SHËRBIMI KORREKTUES

NJËSIA PËR MONITORIMIN E RASTEVE

Njësia për Monitorimin e Rasteve e EULEX-it bën vlerësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë të Kosovës në aspektin e përputhshmërisë procedurale, ligjore dhe të drejtave të njeriut. Monitorimi i EULEX-it përfshin raste të përzgjedhura në tërë zinxhirin e sistemit të drejtësisë penale – d.m.th. në nivel policor, prokurorial dhe gjyqësor, si dhe aspekte të sistemit të drejtësisë civile.

NJËSIA KORREKTUESE

Përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit, Njësia Korrektuese e EULEX-it mbështet Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK) për të konsoliduar një ekip drejtues profesional dhe për të ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e trajtimit të barabartë dhe luftimin e ndërhyrjeve të panevojshme dhe trajtimit preferencial të burgosurve.

EULEX-i po ashtu i ndihmon Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK) për zhvillimin e qasjes së strukturuar ndaj rehabilitimit të personave që janë në sprovim me fokus në parandalimin e recidivizmit.

EKIPI I MJEKËSISË LIGJORE

Përmes ofrimit të ekspertizës për identifikimin e varreve, zhvarrosjen dhe identifikimin e personave të zhdukur, ekspertët forenzik të EULEX-it punojnë me Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) dhe institucionet e tjera për ta zbardhur fatin e personave të zhdukur të ndërlidhur me konfliktin e Kosovës, pavarësisht rrethanave të zhdukjes së tyre, prejardhjes etnike, fetare apo kombëtare të tyre, apo karakteristikave të tjera.



INFORMATAT DHE OPERACIONET POLICORE

NJËSIA POLICORE E SPECIALIZUAR

EULEX-i është reaguesi i dytë i sigurisë i Kosovës, si pjesë e një mekanizmi me tre nivele të reaguesve të sigurisë, ku Policia e Kosovës është reaguesi i parë ndërsa KFOR-i është reaguesi i tretë. Njësia Policore e Specializuar e EULEX-it (NJPS) patrullon, monitoron dhe angazhohet me komunitetet, e gatshme për ta mbrojtur, nëse kërkohet dhe nëse është e nevojshme, të drejtën e të gjitha komuniteteve për siguri, jetë, dhe pronë, për të kontribuar në ruajtjen dhe promovimin e rendit dhe sigurisë publike në rast të trazirave civile.

Kapaciteti operacional i NJPS-së mund të përforcohet përmes dislokimit të përkohshëm të Njesisë Policore të Specializuar Rezervë, e përbërë prej aseteve të ofruara nga Forca e Xhandarmerisë Evropiane.



NJËSIA E KËSHILLTARËVE POLICORË

EULEX-i këshillon Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicën Veriore dhe katër stacionet policore nën komandën e saj për një numër çështjesh që lidhen me ofrimin e shërbimeve policore, duke përfshirë punën policore në komunitet, si dhe punën në një mjedis shumë-etnik.



BASHKËPUNIMI POLICOR NDËRKOMBËTAR

EULEX-i lehtëson shkëmbimin e informatave policore mes Policisë së Kosovës dhe Interpol-it, Europol-it apo Ministrisë të Brendshme të Serbisë.

EULEX-i asiston Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar me logjistikë dhe mbështetje operationale në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës të Kosovës.

PERSPEKTIVAT E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE ÇËSHTJEVE GJINORE

EULEX-i është i përkushtuar për zbatimin e:

Qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut dhe kujdesin e shtuar për të drejtat e njeriut gjatë zbatimit të mandatit të tij.

Agjendës 'Gratë, Paqja dhe Siguria (GPS)' – si mjet thelbësor për të siguruar që të drejtat, veprimi dhe mbrojtja e grave dhe vajzave të respektohen dhe mbështeten gjithnjë.

ARRITJET E MISIONIT

Nga qershori 2018 deri më 14 qershor 2026, monitoruesit e Njesisë së EULEX-it për Monitorimin e Rasteve në sektorin e drejtësisë kanë marrë pjesë në: **3,062** seanca gjyqësore në **466** raste aktive penale dhe civile, përfshirë raste të profilin të lartë, raste të krimeve të luftës, raste të dhunës në baza gjinore, raste të korrupsionit, dhe raste që më parë janë trajtuar nga EULEX-i. Nga ky monitorim dalin raporte në të cilat prezantohen gjetje dhe jepen rekomandime për autoritetet e Kosovës me qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Nga qershori 2018 deri më 14 qershor 2026, Njësia Korrektuese e EULEX-it:

- Ka kryer mbi **1,380** vizita në terren në institucione korrektuese të ndryshme dhe zyra rajonale të shërbimit sprovues dhe kanë mbajtur qindra takime me stafin e SHKK-së dhe SHSK-së për mbështetjen e drejtuesve në adresimin e çështjeve strategjike.
- Ka kryer **267** intervista me të burgosur të profilin të lartë, kryesisht që i përkasin komuniteteve jo-shumicë.
- Ka mbështetur trajnime, punëtori dhe grupe punuese për mbi **1,200** pjesëmarrës

Nga qershori 2018 deri më 14 qershor 2026, Ekipi i Mjekësisë Ligjore i EULEX-it ka mbështetur në mënyrë aktive homologët e tij nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në **374** operacione në teren, përfshirë **81** zhvarrime. Ekspertët e EULEX-it po ashtu kanë vazhduar mbështetjen e IML-së në kryerjen e ekzaminimeve të mbetjeve mortore të gjetura kohëve të fundit, si dhe në procesin e rishikimit të disa qindra mbetje mortore të ruajtura në morgun e IML-së. Në përgjithësi, Misioni ka ndihmuar IML-në për dorëzimin e **428** mostrave për analizë të ADN-së dhe për dorëzimin e mbetjeve mortore të familjarët e **134** viktimave të identifikuara.

Nga qershori 2018 deri më 14 qershor 2026, EULEX-i ka lehtësuar shkëmbimin e informatave policore si në vazhdim:

- **2,048** mes Policisë së Kosovës dhe Europol-it.
- **4,320** mes Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Brendshme të Serbisë, në përputhje me protokollin mbi bashkëpunimin policor midis dy entiteteve.
- **17,725** mes Njesisë së Policisë së Kosovës për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit nën ombrellën e Zyrës Ndërlidhëse të Interpolit brenda UNMIK-ut dhe Byrove Qendrore Kombëtare të Interpol-it.



Numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të Misionit: ≈ 400 staf vendas dhe ndërkombëtarë

EULEX-i mbështetet nga:



dhe



eulex.kosovo



eulexkosovo



eulex.kosovo



eulexkosovo



EULEXKosovo



eulex-mission-in-kosovo



www.eulex-kosovo.eu



press@eulex-kosovo.eu

info@eulex-kosovo.eu